

Arta Behrami Berisha

Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

Rëndësia e përdorimit të drejtë të zanores *ë* në shkrim nga nxënësit e klasës së VII-të

ABSTRAKT

Gjuha shërben si mjet komunikimi ndërmjet njerëzve, nëse jemi folës të së njëjtës gjuhë ne do të arrijmë të kuptohemi më mirë ndërmjet vete, si dhe do të kemi mundësi që ta kultivojmë, ta flasim e ta shkruajmë në mënyrë sa më të drejtë e të paraparë me rregullat drejtshqiptimore e drejtshkrimore të gjuhës shqipe.

Meqenëse nxënësit bëjnë gabime në të shkruarit e zanores *ë* gjithmonë kam pasur dëshirë që të hulumtoj më tutje për këtë temë, sepse më kujtohet, që si nxënës dhe si studentë e kemi pasur mjaft të vështirë përdorimin korrekt të zanores *ë* në të shkruarit e saj, andaj kam dashur ta paraqes përdorimin e saj nga nxënësit e klasës së VII-të, si dhe përmirësimin, që ata mund ta bëjnë përgjatë aktiviteteve mësimore.

Përmes punimit do të njoftohemi se a ka mundësi që nxënësit t'i përmirësojnë gabimet e tyre drejtshkrimore si dhe nëse po cilat janë disa nga metodat të cilat mund t'i aplikojnë ata në përmirësimin e tyre. Si pjesëmarrës të këtij hulumtimi do të jenë 200 nxënës të klasës së VII-të nga mësimdhënës të ndryshëm. Studimi u bë në komunën e Podujevës më saktësisht në shkollat fillore të mesme të ulëta të kësaj komune. Shkollat në të cilat u realizua hulumtimi ishin: “Ibrahim Rugova”, “Xheladin Rekalu”, “Shaban Shala” dhe “Naim Frashëri”.

Metodologjia e këtij studimi është kuantitativ (sasior), kurse modeli është përshkruar (deskriptiv). Instrument i këtij studimi është pyetësori i formuluar për nxënësit nga shkollat e ndryshme të Komunës së Podujevës.

Të dhënat u mbledhën përmes pyetësorëve të cilat ishin në përputhje me etikën e punës hulumtuese. Pas administrimit të pyetësorëve analiza e të dhënave u bë përmes statistikave nga përgjigjet e nxjerra nga pjesëmarrësit në hulumtim, si rrjedhojë kështu u përshkruan edhe karakteristikat e të dhënave.

Fjalët çelës: *përdorim, i drejtë, drejtshkrim, zanorja ë, gjuhë shqipe.*

ABSTRACT

Language serves as a means of communication among people. When we are speakers of the same language, we will be able to understand each other and to cultivate it more effectively by speaking and writing it correctly, in accordance with the orthoepic and orthographic rules of the Albanian language.

Since students frequently make mistakes in writing the vowel *ë*, there has always been an interest in further researching this topic. Recalling personal experience as both a pupil and a student, the correct written use of the vowel *ë* proved to be quite challenging. Therefore, this study aims to present the use of this vowel by seventh grade students, as well as some of the methods that contribute to the acquisition of its correct orthographic usage through various teaching and learning activities.

Through this paper, it is examined whether students are able to improve their orthographic errors and, if so, which methods can be applied to achieve such improvement. The participants in this research consist of 199 seventh-grade students taught by different teachers. The study was conducted in the municipality of Podujeva, more specifically in the lower secondary schools of this municipality. The schools in which the research was carried out are: “Ibrahim Rugova”, “Xheladin Rekaliu”, “Shaban Shala”, and “Naim Frashëri”.

The methodology of this study is quantitative, while the research design is descriptive. The research instrument used is questionnaire designed for students from different schools in the municipality of Podujeva.

The data were collected through questionnaires and were in accordance with research ethics. Following the administration of the questionnaires, data analysis was conducted using statistical methods based on the responses obtained from the research participants and the characteristics of the data were also described.

Key words: *correct use, orthography, writing, vowel ë, Albanian language.*